



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 903 Prot.

BASHKIA PATOS

Patos, më 05/04 /2024

MIRATOHET  
KRYETARI  
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 32, datë 05/04 /2024

**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT STANDARD PËR EFEKT TË PËRLLOGARITJES SË SIPËRFAQES SË TRUALLIT, NDËRTESESË DHE HAPËSIRËS PUBLIKE PËR BIZNESET NË BASHKINË PATOS**

### KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur në nenin 54 shkronja "k" të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, VKB-në nr. 71, datë 30.11.2023 "Mbi strukturë dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2024, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e procesverbalit standard për efekt të përlogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapsirës publike për bizneset në bashkinë Patos, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi.

PËRGJ.SEKTORIT JURIDIK

Nurkë Hazizaj

DR. ARDHURAVE VENDORE

Astrit Murati

ZV/KRYETARE

Ina Sauli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 903 / Prot.

Patos, më 05/04 /2024

**RELACION**  
**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT STANDARD PËR EFEKT TË**  
**PËRLLOGARITJES SË SIPËRFAQES SË TRUALLIT, NDËRTESES DHE HAPËSIRËS**  
**PUBLIKE PËR BIZNESET NË BASHKINË PATOS**

Për efekt të taksimit sa më të saktë, të drejtë dhe real të taksave dhe tarifave vendore për bizneset që ushtrojnë aktivitetet në territorin e bashkisë Patos, me urdhërin nr. 77, datë 02.04.2024 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për verifikimin e sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike të bizneseve i përbërë nga disa grupe.

Ky proces ka si qëllim në vetvete krijimin e një database të saktë përsa i përket taksës së pasurisë ndërtesë dhe truall të cilat janë në funksion të biznesit. Gjithashtu edhe tarifa e hapësirës publike e cila përdoret nga bizneset për funksion të aktivitetit të tyre është një e ardhur ne buxhetin e bashkisë.

Mbështetur në nenin 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, VKB-në nr. 71, datë 30.11.2023 "Mbi strukturë dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2024, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e procesverbalit standard për efekt të përllogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike për bizneset në bashkinë Patos, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen grupet e punës të përcaktuara në urdhërin e mësipërm dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

PËRGJ.SEKTORIT JURIDIK

Nurkë Hazizaj

DR. ARDHURAVE VENDORE

Astrit Murati

ZV/KRYETARE

Ina Sauli

KRYETARI  
Fation Duro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024

PROÇESVERBAL STANDARD

Mbi verifikimin e sipërfaqes së truallit, ndërtesës, dhe hapësirës publike të bizneseve në  
Bashkinë Patos

I mbajtur sot më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024 midis komisionit të ngritur me urdhër të Kryetarit nr. \_\_\_\_, datë \_\_. \_\_.202\_\_ për verifikimin e sipërfaqes së truallit, ndërtesës, dhe hapësirës publike të bizneseve në Bashkinë Patos i përbërë nga ;

dhe përfaqësuesit të biznesit z/znj \_\_\_\_\_ me NIPT \_\_\_\_\_  
ku u konstatua se:

1. Nr. kateve të ndërtesës është \_\_\_\_.
2. Nr. kateve në funksion të biznesit është \_\_\_\_.
3. Nr. kateve për banim është \_\_\_\_.
4. Sipërfaqja e truallit është \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>.
5. Sipërfaqja totale e ndërtesës në funksion të biznesit është \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>.
6. Sipërfaqja e hapësirës publike në funksion të biznesit është \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>.
7. Dokumentacioni i pronësisë që disponon \_\_\_\_\_.
8. Sipërfaqja e ndërtesës që disponon pa dokumentacion pronësie është \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>.

Shpjegime: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Ky procesverbal mbahet në 2 (dy) kopje (1 kopje grupi i punës, 1 kopje përfaqësuesi i biznesit).

Komisioni:

Përfaqësues i biznesit: